



Teksti zyrtar siç është amendamentuar me 11.11.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të nenit 64.2 pika (a) dhe (b) dhe nenit 126.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenit 29.2 dhe 20 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nxjerr:

RREGULLËN ZGJEDHORE Nr.14/2009 SANKSIONET DHE GJOBAT

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Gjobë” do të thotë një shumë e të hollave që shqiptohet për shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe akteve nënligjore.

1.2 “Sanksion” do të thotë masë ndëshkuese që për shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 03/L-037 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-037 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe akteve nënligjore.

Neni 2 Dispozitat e përgjithshme

2.1 Të gjithë personat dhe subjektet që marrin pjesë në procesin zgjedhor obligohen t’i respektojnë ligjet në fuqi dhe procesin zgjedhor, përfshirë edhe rregullat zgjedhore.

2.2 KQZ-ja sipas rekomandimit të Zyrës mund të shqiptojë dënime për shkeljen e dispozitave të ligjit, kur ato nuk përbëjnë vepër penale dhe nuk janë në kompetencë të PZAP-it, e që janë të dënueshme me një gjobë prej 200 deri në 2.000 Euro bazuar në nenin 126.1 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë nr. 03/L-073.

2.3 Vendimi i KQZ-së mbi sanksionet dhe gjobat mund të apelohej në pajtueshmëri me Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë nr. 03/L-073.

2.4 Ngarkimi i ndonjë gjobe ose sanksioni tjetër nga KQZ-ja nuk paragjykon ndonjë sanksion penal që mund të jetë i aplikueshëm. Rastet të cilat implikojnë ndonjë sanksion penal duhen të përcillen nga KQZ-ja në Zyrën e Prokurorit të Kosovës.

Neni 3
Dorëzimi me vonesë i dokumentacionit

3.1 KQZ-ja sipas rekomandimit të Zyrës gjombite subjektet politike për vonesën e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar sipas nenit 9, 10,13, 20 dhe 24 të Rregullës së KQZ-së nr. 01/2008 Mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike dhe i kategorizon sipas kriterit të përfaqësimit dhe afateve.

a) Subjektet politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës për vonesën nga:

- 1) **1-5 ditë më shumë prej300 €**
- 2) **6-10 ditë në shumë prej320 €**
- 3) **11-15 ditë në shumë prej350 €**

b) Subjektet politike, të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, për vonesën nga:

- 1) **1-5 ditë me shumë prej200 €**
- 2) **6-10 ditë në shumë prej220 €**
- 3) **11-15 ditë në shumë prej250 €**

Neni 4
Mbajtja jo e rregullt e shënimeve

4.1 Secili subjekt politik që nuk mban dhe përditëson shënime financiare të sakta dhe të hollësishme për periudhën e fundit shtatë (7) vjeçare, do të gjobiten.

4.2 Subjektet politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës për mbajtjen jo të rregullt të shënimeve në pajtueshmëri me Rregullën e KQZ-së nr. 01/2008 do të gjobiten:

- a) **Librat e kontabilitetit250 €**
- b) **Faturat për shpenzimet që tejkalojnë 100 € gjobiten..... 300 €**
- c) **Raportet bankare350 €**
- d) **Dokumentet për pronësinë e vërtetë mbi pronën 400 €**
- e) **Kontratat për blerje ose qira450 €**
- f) **Regjistrin e të gjithë anëtarëve të partisë500 €**
- g) **Regjistrin e të gjitha kontributeve550 €**

4.3 Subjektet politike të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës për mbajtjen jo të rregullt të shënimeve në pajtueshmëri me Rregullën e KQZ-së nr. 01/2008 do të gjobiten:

- a) **Librat e kontabilitetit200 €**
- b) **Faturat për shpenzimet që tejkalojnë 100 € gjobiten230 €**
- c) **Regjistrat bankare250 €**
- d) **Dokumentet për pronësinë e vërtetë mbi pronën280 €**
- e) **Kontratat për blerje ose qira300 €**
- f) **Regjistrin e të gjithë anëtarëve të partisë330 €**
- g) **Regjistrin e të gjitha kontributeve350 €**

Neni 5
Fshehja e të ardhurave materiale, shpenzimeve, kontributeve dhe shërbimeve

5.1 Subjekti politik që nuk paraqet secilën të hyrë materiale, shpenzim apo kontribut, do të gjobitet.

5.2 Subjektet politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës në pajtueshmëri me Rregullën e KQZ-së nr. 01/2008 do të gjobiten.

- a) Dështimi për të ditur të ardhurat**600 €**
- b) Dështimi për të ditur shpenzimet..... **630 €**
- c) Dështimi për të ditur kontributin.....**650 €**

5.3 Subjektet politike të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës në pajtueshmëri me Rregullën e KQZ-së nr. 01/2008 do të gjobiten.

- a) Dështimi për të ditur të ardhurat**400 €**
- b) Dështimi për të ditur shpenzimet **430 €**
- c) Dështimi për të ditur kontributin**450 €**

Neni 6

Pranimi i kontributeve të palejueshme

6.1 Nëse nuk kthehet kontributi i palejueshëm sipas nenit 17 të Rregullës e KQZ-së nr. 01/2008 subjekti politik që pranon kontributin e palejueshëm do të gjobitet sipas kësaj Rregulle.

6.2 Subjektet politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës në pajtueshmëri me Rregullën e KQZ-së nr. 01/2008 do të gjobiten:

- a) Nëse kontributi i palejueshëm është deri $\frac{1}{4}$ e të gjitha kontributeve**700 €**
- b) Nëse kontributi i palejueshëm është në mes $\frac{1}{4}$ dhe $\frac{2}{4}$ e të gjitha kontributeve**1.000 €**
- c) Nëse kontributi i palejueshëm është në mes $\frac{2}{4}$ dhe $\frac{3}{4}$ e të gjitha kontributeve..... **1.300 €**
- d) Nëse kontributi i palejueshëm është në mes $\frac{3}{4}$ dhe $\frac{4}{4}$ e të gjitha kontributeve..... **1.600 €**

6.3 Subjektet politike të cila nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës në pajtueshmëri me Rregullën e KQZ-së nr. 01/2008 do të gjobiten:

- a) Nëse kontributi i palejueshëm është deri $\frac{1}{4}$ e të gjitha kontributeve**400 €**
- b) Nëse kontributi i palejueshëm është në mes $\frac{1}{4}$ dhe $\frac{2}{4}$ e të gjitha kontributeve..... **600 €**
- c) Nëse kontributi i palejueshëm është në mes $\frac{2}{4}$ dhe $\frac{3}{4}$ e të gjitha kontributeve**800 €**
- d) Nëse kontributi i palejueshëm është në mes $\frac{3}{4}$ dhe $\frac{4}{4}$ e të gjitha kontributeve**1.000 €**

Neni 7

Mos deklarimi ose falsifikimi i shënimeve financiare

7.1 Subjekti politik që nuk i deklaron ose falsifikon shënimet e saj financiare gjobitet sipas pikave vijuese të këtij neni.

7.2 Subjektet politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës në pajtueshmëri me Rregullën e KQZ-së nr. 01/2008 do të gjobiten:

- a) Nëse shuma e fshehur/falsifikuar është deri $\frac{1}{4}$ e kategorisë përkatëse**1.700 €**

- b) Nëse shuma e fshehur/falsifikuar është ndërmjet 1/4 deri 2/4 të kategorisë përkatëse**1.800 €**
- c) Nëse shuma e fshehur/falsifikuar është ndërmjet 2/4 deri 3/4 të kategorisë përkatëse..... **1.900 €**
- d) Nëse shuma e fshehur/falsifikuar është ndërmjet 3/4 deri 4/4 të kategorisë përkatëse**2.000 €**

7.3 Subjektet politike të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës në pajtueshmëri me Rregullën e KQZ-së nr. 01/2008 do të gjobiten:

- a) Nëse shuma e fshehur/falsifikuar është deri 1/4 e kategorisë përkatëse**1.100 €**
- b) Nëse shuma e fshehur/falsifikuar është ndërmjet 1/4 deri 2/4 të kategorisë përkatëse **1.200 €**
- c) Nëse shuma e fshehur/falsifikuar është ndërmjet 2/4 deri 3/4 të kategorisë përkatëse**1.300 €**
- d) Nëse shuma e fshehur/falsifikuar është ndërmjet 3/4 deri 4/4 të kategorisë përkatëse..... **1.400€**

Neni 8
Sanksionet

Komisioni Qendror Zgjedhor përmes lirisë së veprimit mund të sanksionoj apo fillojë sanksionimin e cilitdo zyrtar zgjedhor (Komisionet Komunale të Zgjedhjeve, Komisionet e Vendotimeve) dhe cilindo nëpunës të punësuar nga SKQZ për të organizuar dhe zbatuar zgjedhjet. Subjektet Politike, organizatat dhe personat tjerë apo grupet e individëve siç është definuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën së Kosovës, Rregullat Zgjedhore të KQZ-së dhe të çfarëdo dispozite ligjore të aplikueshme.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull e ndryshuar zëvendëson Rregullën e mëparshme mbi Sanksionet dhe Gjobat dhe hyn në fuqi më 25.06.2009.

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve